

## **Komuna e Obiliqit:** **problemet kryesore dhe trendët buxhetor**

### **Hyrje**

1. Komuna e Obiliqit udhëhiqet nga kryetari Mehmet Krasniqi i cili vjen nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Ai e ka fituar këtë mandat në zgjedhjet e fundit lokale në vitin 2009.
2. Obiliqi gjendet në pjesën qendrore të Kosovës, që përfshin një sipërfaqe prej 105km<sup>2</sup>. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, Obiliqi numëron 21.549 banorë.<sup>1</sup> Komuna e Obiliqit është komuna me ndotjen mjedisore më të madhe në Kosovë.
3. Kuvendi Komunal i Obiliqit ka 21 anëtarë, ku PDK udhëheq me gjashtë përfaqësues, pastaj vjen LDK dhe AAK me nga pesë përfaqësues, dy nga Lëvizja për Bashkim dhe nga një përfaqësues nga Aleanca Kosova e Re dhe Partia e Drejtësisë. Në Obiliq funksionojnë nëntë drejtori, ku shtatë i udhëheq LDK dhe dy AAK.
4. Në bazë të hulumtimit të opinionit të qytetarëve nëpër komunat e vendit i realizuar nga UNDP, 45% e qytetarëve në Obiliq janë shprehur të kënaqur me punën e kryetarit të komunës (në krahasim me mesataren e kënaqshmerisë në nivel të Kosovës e cila është 69%). Ndërsa në një hulumtim REC (Qendra Regjionale e Mjedisit) i publikuar në vitin 2012, si prioritet i së ardhmes nga banorët e Komunës së Obiliqit është vlerësuar industria, bujqësia dhe ekologjia.<sup>2</sup>
5. Sipas hulumtimeve të Institutit GAP, në vitin 2009 problemet kryesore të qytetarëve të Komunës së Obiliqit ishin: ajri i ndotur, kualiteti jo i mirë i ujit të pijes, gjendja jo e mirë në shëndetësinë primare, vendbanimet jo të qëndrueshëm si pasojë e shpalljes së 75% të territorit si zonë të interesit të veçantë ekonomik dhe gjendja jo e mirë në sistemin arsimor.<sup>3</sup>

<sup>1</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave - 2012. Komuna e Obiliqit. Burimi: [http://esk.rks.gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore\\_ALB.pdf](http://esk.rks.gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf)

<sup>2</sup> Qendra Regjionale për Mjedis. Komuna e Obiliqit. Raporti i të gjeturave nga Hulumtimit mbi Planin e veprimtimit lokal në Mjedis. Fq 124.

<sup>3</sup> Institutit GAP. Obiliqi – raporti komunal. Nëntor 2009. Burimi:

[http://www.institutigap.org/documents/9705\\_Obiliqi-raporti%20komunal.pdf](http://www.institutigap.org/documents/9705_Obiliqi-raporti%20komunal.pdf)

6. Në hulumtimin e Institutit GAP i realizuar në nëntor të vitit 2009, problemet më të mëdha në Komunën e Obiliqit kanë qenë ndotja e ajrit, mungesa e ujit të pijes, shërbimet e dobëta në sektorin e shëndetësisë, mungesa e cilësisë në sektori e arsimit si dhe vendbanimet jo të qëndrueshme.<sup>4</sup>

## Problemet kryesore në Komunën e Obiliqit 2013

1. **Ndotja e ambientit.** Banorët e kësaj komune përballen me probleme të cilët pjesa më e madhe janë të lidhura me praninë e termocentraleve në qytet. Në territorin e kësaj komune operojnë dy termocentrale me bazë qymyri të cilat shkaktojnë ndotje të madhe.<sup>5</sup> Andaj, si pasojë e kësaj ndotje, shkaktohen dëme të mëdha në ambient, kontaminim të tokës, ajrit, ujit dhe ndikime negative në shëndet.<sup>6</sup> Qytetarët e Komunës së Obiliqit janë më të rrezikuarit nga sëmundjet që shkaktohen nga djegia e qymyrit. Shumë banorë që jetojnë përreth termocentraleve ankojnë nga sëmundje të ndryshme të frymëmarrjes, kancerit, sëmundje kardio-vaskulare, sëmundje të syve, etj. Sipas të dhënave të grumbulluara në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe spitalet regjionale, shkalla e sëmundjes në organet respiratore në komunën e Obiliqit është 30%, apo përgjysmë më e lartë në krahasim me komunat tjera, mesatarja 17% e të cilave sillet në 14.26%.<sup>7</sup> Në gjashtë muajt e parë të vitit 2012, në këtë komunë janë paraqitur gjashtë raste me kancer.<sup>8</sup> Gjatë vitit 2012, në kujdesin primar shëndetësor në Obiliq kanë kërkuar ndihmë 57.520 pacientë.<sup>9</sup> Komuna e Obiliqit ka 21.549 banorë, çka do të thotë se shumica e popullsisë ka vizituar shëndetësinë primare më shumë se dy herë brenda një viti. Sipas hulumtimit të REC, në pyetjen “Si e vlerësoni gjendjen e tanishme mjedisore në territorin e komunës suaj?” 94% e respondentëve nga Obiliqi janë përgjigjur se gjendja në territorin e komunës së tyre është e pakënaqshme.

<sup>4</sup> Instituti GAP. Obiliq, raporti komunal. Fq 7. 2009. Burimi:

[http://www.institutigap.org/documents/9705\\_Obiliqi-raporti%20komunal.pdf](http://www.institutigap.org/documents/9705_Obiliqi-raporti%20komunal.pdf)

<sup>5</sup> Agjencia e Lajmeve “Evropa e lire”. Autor, Ariana Kasapolli. 03.04.2011. Ndotja kërcënon banorët e Obiliqit. Burimi: <http://www.evropaelire.org/content/article/3545433.html>

<sup>6</sup> Gazeta “Koha Ditore”. 04.04.2013. Protestë në Obiliq kundër ndotjes se KEK-ut. Burimi: <http://kohaditore.com/?page=1,13,141294>

<sup>7</sup> Dr.Xhevat Pllana. Instituti i Mjekësisë së Punës dhe Mbrojtjes Radiologjike. Prezantimi me titull “Sëmundjet respiratorë dhe sëmundjet tjera si pasojë e ndikimit të thëngjillit në shëndet”, 1 nëntor 2012, Prishtinë.

<sup>8</sup> Komuna e Obiliqit. Raporti Gjashtëmujor 2012–Raporti i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

<sup>9</sup> Komuna e Obiliqit. Raporti Njëvjeçar 2011–Raporti i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Qytetarët madhe edhe kanë humbur optimizmin se gjendja do të përmirësohet. Sipas REC, 48.1% e respondentëve se gjendja në pesë vitet në vazhdim do të jetë e njejtë.<sup>10</sup>

**2. Deponia e Mirashit.** Kjo deponi e mbeturinave është regjionale dhe mbeturinat sillen nga Prishtina, Podujeva, Lipjani, Graçanica, Fushë Kosova dhe Drenasi. Deponia lëshon erëra të rënda dhe ndikon negativisht në gjendjen e ambientit. Kjo është konstatuar edhe nga ana e eksperteve të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë.<sup>11</sup> Në pjesën dërmuese të kohës mbeturinat digjen duke shkaktuar tym të vazhdueshëm. Komuna e Obiliqit ka kompetenca për të obliguar përgjegjësit e deponisë që shkalla e mirëmbajtjes së saj të brendshme të jetë në përputhje me standardet e kërkuara duke pamundësuar kësaj rrezeje ndezjen e mbeturinave dhe shpërndarjen e tyre jashtë diametrit të deponisë. Mos reagimi i komunës e ka shtyrë Ministrinë e Ambientit që këtë çështje ta adresojë në Gjykatën Komunale të Prishtinës.<sup>12</sup> Sipas hulumtimit të organizatës REC, në pyetjen se “Cilat janë tri problemet që më së shumti ndikojnë negativisht në cilësinë e jetës në lagjen tuaj?”, respondentët nga Obiliqi kanë përzgjedhur deponitë e mbeturinave si shqetësimin më të madh.<sup>13</sup>

**3. Problemet me ujin e pijes.** Ngjashëm si komunat e tjera të regjionit të Prishtinës, edhe Komuna e Obiliqit përballet me mungesë të theksuar të ujit të pijes, veçmas gjatë sezonit të verës. Reduktimet janë më të theksuara në zonat urbane të kësaj ane.<sup>14</sup> Probleme nga mungesa e ujit të pijes kanë edhe fshati Mazgit i poshtëm, fshati Plemetin dhe fshati Milloshevë. Pjesa dërmuese e banorëve në këto fshatra, pavarësisht se kanë qasje në ujësjellës, kanë hapur edhe pusët private nga të cilat marrin ujin, por që cilësia e këtij uji nuk është verifikuar nga ndonjë institucion, veçmas kur kihet parasysh se toka e kësaj ane përmban sasi të madhe të linjtit si dhe shkalla e kontaminimit të ambientit nga termocentralet vlerësohet të jetë e lartë. Në bazë të hulumtimit të opinionit të qytetarëve nëpër komuna i realizuar nga UNDP, rezulton se furnizimi me ujë nga ujësjellësi publik në Obiliq është

<sup>10</sup> Qendra Regjionale për Mjedis. Komuna e Obiliqit. Raporti i të gjeturave nga Hulumtimit mbi Planin e veprimtimit lokal në Mjedis. Fq 123.

<sup>11</sup> Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë. Publikim. Gjendja e rendit në deponinë e Mirashit. Burimi: <http://www.amnk-rks.net/?page=1,7,86>

<sup>12</sup> Agjencia e lajmeve “Kosova Press”. Ministria e Ambientit çështjen e Mirashit e dërgon në Gjykatë. Burimi: <http://www.kosovapress.com/sq/arkiva/ministria-e-mjedisit-ceshtjen-e-deponise-se-mirashit-e-dergon-ne-gjykate-54061/?old=1>

<sup>13</sup> Qendra Regjionale për Mjedis. Komuna e Obiliqit. Raporti i të gjeturave nga Hulumtimit mbi Planin e veprimtimit lokal në Mjedis. Fq 124.

<sup>14</sup> Përgjegjësit e ujësjellësit Prishtina në Obiliq. Shkrese zyrtare. Burimi: <http://kk.rks.gov.net/obiliq/getattachment/a793412d-4864-485b-b1dd-f7166cbbcacc/Banoret-e-Komunes-se-Obiliqit--ballafaqohen-me-reduktime-te-ashpra-te-ujit-te-pijes.pdf.aspx>

mjaft problematik. Njëmbëdhjetë përqind e familjeve në Obiliq kanë kufizime të ujit që zgjasin prej 1 deri në 4 orë në ditë, 17% prej 5 deri në 10 orë në ditë, 8% më shumë se 11 orë në ditë, kurse 25% më shumë se 3 orë në çdo ndërprerje gjatë ditës. Cilësia e ujit të pijshëm nga ujësjellësi publik në Obiliq është shumë më e dobët në krahasim me mesataren e Kosovës. Njëzet e shtatë përqind e familjeve të lidhura me ujësjellësin publik pohojnë se uji i çezmës është i turbullt nga papastërtia, 38% se shtypja e tij është shumë e ulët për shfrytëzim shtëpiak, 19% se ka shije të keqe, kurse 17% thonë se uji i çezmës ka erë të keqe.<sup>15</sup>

**4. Zgjerimi i hapësirave të gjelbëruara.** Komuna e Obiliqit ka hapësira të pakta të gjelbëruara. Një park i rregulluar në afërsi të komunës dhe shtëpisë së kulturës është dëmtuar dhe nuk shfrytëzohet si vend i pushimit dhe rekreacionit nga banorët. Ulëset janë thyer, ndriçimi publik nuk punon dhe mbeturinat nuk pastrohen me rregull. Në gjithë qytetin e Obiliqit, ka vetëm një shteg përgjatë rrugës kryesore e cila është e gjelbëruar dhe mirëmbahet mirë. Në asnjë zonë tjetër nuk ka park të rregulluar dhe të destinuar për shfrytëzimin e qytetarëve për pushim apo dalje. Në bazë të hulumtimit të UNDP-së, rreth 33% e banorëve të Obiliqit në krahasim me mesataren e kosovarëve 58% janë të kënaqur me pastërtinë e përgjithshme të komunës së tyre, kurse vetëm 11%, në krahasim me 48% të mesatares së kosovarëve, janë të kënaqur me mbrojtjen e mjedisit. Më e ulët se mesatarja e Kosovës janë përqindja e banorëve të Obiliqit që janë të kënaqur me disponueshmërinë e parqeve dhe shesheve (29%) dhe përdorshmërinë e tyre (27%), dhe me shërbimet e grumbullimit të mbeturinave të ngurta (38%), janë.<sup>16</sup>

**5. Mungesa e shkollës në fshatin Leshkoshiq dhe fshatin Babimoc.** Banorët e këtyre dy fshatrave përballen me mungesë të objekteve shkollore. Autoritetet lokale gjatë katër viteve të kaluara nuk kanë ndërtuar objekte të reja shkollore. Në këto dy fshatra jetojnë më shumë se një mijë banorë. Megjithatë Komuna e Obiliqit nuk qëndron keq në distancë të objekteve shkollore. Kështu në bazë të hulumtimit të UNDP-së, institucioni më i afërt parashkollor mund të arrihet mesatarisht për 20 minuta (njëlloj sa mesatarja e Kosovës), shkolla më e afërt fillore mesatarisht për 11 minuta (në krahasim me mesataren e Kosovës prej 14 minuta),

<sup>15</sup> Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim -UNDP. "Mozaiku i Kosovës". 2012. Fq 111. Burimi:[http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo\\_Mosaic\\_2012\\_Albanian\\_216825.pdf](http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Albanian_216825.pdf)

<sup>16</sup> Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim -UNDP. "Mozaiku i Kosovës". 2012. Fq 112. Burimi:[http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo\\_Mosaic\\_2012\\_Albanian\\_216825.pdf](http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Albanian_216825.pdf)

kurse shkolla më e afërt e mesme arrihet për mesatarisht 28 minuta (në krahasim me mesataren e Kosovës 25 minuta).

**6. Ndotja e lumenjve.** Në Komunën e Obiliqit gjenden tre lumenj, lumi Sitnica, lumi Llap dhe lumi Drenica. Lumi Sitnica ka gjatësinë më të madhe në këtë komunë.<sup>17</sup> Lumenjtë janë të ndotur nga hedhja e mbeturinave dhe derdhja e kanalizimeve në rrjedhën e tyre. Pamja e lumenjve ngjason në deponi mbeturinash. Era e keqe që përhapet shqetëson një numër të madh të banorëve, veçmas përgjatë zonave Plemetin, Bellacerkë, Sibovc, Hamidi dhe Dobrosellë. Autoritetet komunale nuk kanë ndërmarr ndonjë nismë në rregullimin e shtretërve të këtyre lumenjve, por edhe për kundër disa aksioneve të nisura nga komuna për pastrimin e tyre, hedhja e mbeturinave nga ana e qytetarëve nuk është ndaluar.

**7. Mungesa e Shtëpisë së Kulturës dhe Qendrës Rinore.** Komuna e Obiliqit nuk ka shtëpi të kulturës. Objekti i shtëpisë së kulturës në qendër të qytetit është pronë e KEK-ut dhe kjo ndërmarrje ka mbyllur këtë objekt ngase komuna nuk ka pranuar që dy punonjësit e këtij objekti të futen në listën e pagave të komunës.<sup>18</sup> Obiliqi ka edhe një shtëpi të kulturës në fshatin Milloshevë, por kjo shtëpi kryesisht qëndron e mbyllur dhe nuk shfrytëzohet aktivitete, për shkak të largësisë gjeografike mes qytetit dhe këtij lokaliteti. Mungesa e Shtëpisë së Kulturës e bën jetën kulturore në këtë qytet të varfër. Mungojnë shfaqjet, ekspozitat dhe aktivitetet e tjera të ngjashme. Obiliqi po ashtu nuk ka objekt të Qendrës Rinore.

## Gjërat pozitive të cilat duhet mirëmbajtur

**1. Mulliri i Behramajve - Graboc.** Njëri ndër objektet më të vjetra dhe me karakteristike në këtë komunë është mulliri i ashtuquajtur i Behramajve në fshatin Grabovc. Ky mulli duhet konservuar dhe ruajtur. Si objekt ka hyrë në mesin e objekteve të veçanta të komunës nga ana e autoriteteve lokale, por nuk është investuar në evitimin e shkatërrimit të mëtutjeshëm të tij.

<sup>17</sup> Agjencia e lajmeve "Telegraf". 04.04.2013. KEK-u ka shndërruar ajrin e pastër ne helm. Burimi: <http://www.telegrafi.com/ekonomi/kek-u-ka-shnderruar-ajrin-e-paster-ne-helm-46-14326.html>

<sup>18</sup> Buletini "Obiliqi". Fq 6 & 7. Riaktivizohet Ansambli i Këngëve dhe

Valleve "Rinia" - 13 nëntor 2011. Burimi: <http://kk.rks->

[gov.net/obiliq/getattachment/Home/Obiliq-Revista-NR2---PDF--Final.pdf.aspx](http://kk.rks.gov.net/obiliq/getattachment/Home/Obiliq-Revista-NR2---PDF--Final.pdf.aspx)



- 2. Parku rekreativ në zonën e Lajthishtes.** Kjo zonë me ndihmën e organizatës gjermane CDF (Fondi Zhvillimor i Konstituimit) është kthyer në një qendër të rëndësishme komunale për aktivitete sportive dhe rekreative për fëmijët dhe të rinjtë. Investimet e bëra duhet të mirëmbahen dhe duhet parandaluar dukuria e vjedhjes së aseteve publike dhe e dëmtimit të tyre.


## Trendet Buxhetore në Komunën e Obiliqit

Komuna e Obiliqit në vitin 2013 do t'i ketë 4.5 milion euro buxhet, ndërsa krahasuar me vitin 2010 (vit kur kryetari i tanishëm ka filluar mandatin) buxheti i kësaj komune është ngritur për 702 mijë euro. Të hyrat vetanake të komunës së Obiliqit në vitin 2012 kanë qenë 622 mijë euro apo 3 mijë euro më pak 2010. Struktura e të hyrave vetanake dominohet nga tatimi në pronë (37%) dhe nga sektori për ekonomi (21%). Edhe pse komuna ka realizuar rreth 91% të planit rreth të hyrave vetanake, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP)<sup>19</sup> ka konstatuar të mos ketë pasur angazhim të mjaftueshëm në inkasimin e të hyrave vetanake. Disa prej rekomandimeve tjera të ZAP-it për vitin 2013 janë që komuna të: a) përmirësoj regjistrimi e pasurisë së saj; b) qartësoj kriteret e subvencionimit dhe; c) përmirësoj cilësinë e raporteve financiare.

---

<sup>19</sup> ZAP, Raporti i Auditimit mbi Pasqyrat Financiare të Komunës së Obiliqit për Vitin e Mbyllur me 31 Dhjetor 2012, 07 Gusht 2013, [http://oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_KOB\\_2012\\_Shqip\\_671535.pdf](http://oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KOB_2012_Shqip_671535.pdf)


Figura 1. Buxheti i Komunës së Obiliqit 2013



Burimi: <http://www.institutigap.org/spendings/?obilig/2013#/~/obilig>

Në bazë të grafikorit rreth ndarjeve buxhetore shohim se pas një ngritje të shpenzimeve kapitale në vitin 2011, ato kanë pësuar rënie prej 467 mijë euro (29%) në vitin 2012. Në vazhdim, në vitin 2012 shpenzimet kapitale përbënin 25% të buxhetit apo 6% pikë përqindje më pak se në vitin 2010.

Figura 2. Trendet e ndarjeve buxhetore 2010- 2013



Në bazë të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2014-2016, Komuna e Obiliqit planifikon t'i rrisë të hyrat e përgjithshme dhe atë kryesisht nga rritja e grantit qeveritar.

Tabela 1. Planifikimi i të hyrave 2014-2016

Të hyrat	2014	2015	2016
Të hyrat totale	4.567.670	4.689.777	4.787.142
Të hyrat vetanake	735.000	757.050	772.191
Grantet	3.832.670	3.932.727	4.014.951



## **Metodologjia e hartimit të raportit**

Instituti GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) janë aktiv në fushën e qeverisjes lokale dhe monitorimin e fushatave para zgjedhore që nga zgjedhjet lokale të 2007. Përgjatë këtyre viteve, në bazë të punës hulumtuese dhe analitike, janë grumbulluar informata për nivelin e qeverisjes lokale, problemet kryesore dhe trendët buxhetore të komunave.

Identifikimi i problemeve kryesore në Komunën e Obiliqi është bërë përmes intervistave dhe fokus grupeve me njerëzit aktiv të komunës, si gazetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile, etj. Të gjeturat e GAP janë mbështetur me të dhënat kuantitative të siguruara përmes anketës së zhvilluar nga ai i UNDP (Mozaiku i Kosovës 2012-shërbimet publike dhe qeverisja lokale në fokus) dhe DEMI/USAID (Raport i Anketimit mbi Kënaqshmërinë e Qytetarëve me Shërbimet Komunale, 2012).



Instituti GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institute të ngjashme në shtetet perëndimore. GAP u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.